


Studimi paratekstual dhe makrostrukturor i romanit 'Il Fu Mattia Pascal'			Literature
		Keywords: përkthimi, vepra letrare, prototeksti, metateksti, romani <i>Il fu Mattia Pascal</i> , etj.	
Mirela Papa	Professor of Translation and Interpretation. Faculty of Foreign Languages. University of Tirana.		
Renata Kristo (Martini)	Professor of Translation. Faculty of Foreign Languages. University of Tirana.		
Abstract			
<p>Në një analizë të mirëfilltë përkthimore të një vepre letrare janë të shumtë elementët të cilët studiohen, krahasohen dhe analizohen në përballjen mes prototekstit dhe metatekstit apo metateksteve në rastet kur përkthimet e veprës letrare janë më shumë se një. Pjesën më të rëndësishme dhe më të gjerë të analizës e zë analiza mikrostrukturorë, por nuk duhet lënë pas dore edhe një tjetër lloj analize e cila duket si dytësore dhe shpeshherë lihet jashtë spektrit të analizës dhe është studimi paratekstual dhe studimi makrostrukturor i tekstit. Në këtë artikull do të japim një model të studimit paratekstual dhe mikrostrukturor të një vepre letrare. Kemi marrë në analizë romanin <i>Il fu Mattia Pascal</i> të autorit italian Luigi Pirandello. Ky roman është përkthyer nga dy përkthyes të ndryshëm, pra kemi dy metatekste të cilat duke u krahasuar edhe mes tyre na nxjerrin në pah edhe strategji të ndryshme që kanë ndjekur përkthyesit në zgjidhjen e problemeve me të cilat janë ndeshur gjatë procesit të përkthimit.</p>			

1. Studimi paratekstual

Ky studim përqendrohet në analizën e çështjeve paraprake që lidhen me publikimin e teksteve të ndryshme të përkthyer. Në këtë kuptim, merren në konsideratë disa faktorë që kanë të bëjnë me prodhimin dhe receiptimin e përkthimeve, për t'iu përgjigjur pyetjeve se *kur, ku, kush dhe për kë* përkthehet. Studimi i këtyre të dhënave paraprake siguron informacionin e duhur që lejon të paraprihen disa nga instrumentet që do të udhëheqin aktivitetin e përkthyesve përkates.

Kjo analizë paratekstuale e aspekteve që lidhen me botimin e teksteve të përkthyer, përfshin kronologjinë, përshkrimin fizik të librit të përkthyer, informacionin mbi botuesin, kolanën dhe përkthyesin⁷⁰, si edhe studimin e disa parateksteve të caktuara. Lidhur me këto të fundit dhe duke ndjekur klasifikimin e Genette-it (1987: 8-11), në këtë nivel mbahen parasysh disa peritekste (prologu i botuesit/përkthyesit⁷¹, ilustrimet) si edhe disa epitekste (njoftime, përmbledhje)⁷².

Brenda nivelit paratekstual merret në konsideratë gjithashtu fakti që mund të ekzistojnë përkthime të ndërmjetme mes tekstit origjinal dhe atij të përkthyer. Në fakt, Toury-ja (1980: 53) përfshin brenda normave paraprake edhe ato që i referohen lidhjes direkte apo indirekte me përkthimin (*directness*)⁷³.

Për sa u përket përkthimeve të Pirandello në gjuhën shqipe, mund të themi që duket fare qartë se bëhet fjalë për përkthime direkte, domethënë teksti bazë që ka shërbyer për punën e përkthyesit ka qenë ai origjinal, i shkruar nga shkrimtari në gjuhën italiane.

1.1 *Tri herë vetrasës, botuar në Shkodër: «Helena Kadare», 2000. përkthyes Sabah RAMJA*

Ky tekst është përkthimi i parë i romanit *Il fu Mattia Pascal* që botohet në vendin tonë. Botohet në vitin 2000. Libri përbëhet nga një vëllim i vetëm me formatin 14X20 cm dhe ka gjithsej 248 faqe. Në kohën kur ka dalë, kushtonte 600 lekë.

Në kopertinën e sipërme shikohet i vetmi ilustrim i këtij romani dhe në atë të pasmen kemi një foto të autorit si dhe një bibliografi të shkurtër të tij.

Në faqen e brendshme shikojmë titullin origjinal të romanit, emrin e përkthyesit Sabah Ramja, të redaktorit Ndrçim Mlika, korrektore Violeta Allmuça si dhe shtëpinë botuese që është «Helena Kadare». Gjithashtu marrim edhe informacionin se ky libër është botuar me ndihmën e firmës Indvis. Tirazhi është 500 kopje.

Duhet të themi se ky përkthim nuk shoqërohet nga ndonjë parathënie.

Për përkthyesin gjejmë të përmendet në një intervistë bërë shkrimtarit dhe përkthyesit Ramiz Lika, botuar në Shqipëria etnike, nr. 22/23 prill 2002.

1.2 *Indjeri Matia Paskal, botuar në Tiranë, «Elena Gjika» 2002, përkthyes Viola CANKO*

Ky tekst është përkthimi i dytë i romanit të Luixhi Pirandello *Il fu Mattia Pascal*. Libri përbëhet nga një vëllim i vetëm me formatin 14X20 cm dhe ka gjithsej 235 faqe. Në kohën kur ka dalë kushtonte 500 lekë dhe nuk ka tirazh.

Në kopertinën e sipërme shikohet i vetmi ilustrim i këtij romani dhe në atë të pasmen kemi një foto të autorit, disa nga titujt e veprave të tij kryesore si dhe rreshtat e fundit që mbyllin romanin.

⁷⁰ Sipas Pym-it (1998: 167), detajet mbi jetën private të përkthyesit do të konsiderohen «only to the extent that they explain what was done in the field of translation».

⁷¹ Peña (1997: 44-45) vëren se prologu i përkthyesit, si ndërhyrje e qartë e tij, është dëshmi e vizibilitetit (dukjes) të tij.

⁷² Genette-i (1987: 8-11) e përshkruan paratekstin si një zonë tranzicioni mes asaj që ka brenda dhe jashtë tekstit. Ky koncept i gjerë përfshin lloje të ndryshme ligjëratash të klasifikuara në dy kategori: periteksti, që përfshin elemente paratekstuale që duken të futura në të njëjtin volum të librit (titulli, prologu, epigrafe, shënime në fund të faqes, ilustrime...) dhe epiteksti, që përfshin mesazhet e vendosura jashtë tekstit, por që i referohen atij (njoftime, buletine editoriale, intervista, etj.).

⁷³ Një përkthim konsiderohet direkt apo i dorës së parë, kur teksti mbërritës rezultoi i përkthyer drejtpërdrejt nga origjinali. Përkthimi indirekt, i quajtur edhe i dorës së dytë, i referohet tekstit mbërritës që përfohet nga përkthimi i një teksti që nga ana e tij është një përkthim nga origjinali. Ky përkthim që përdoret si burim për të realizuar një tjetër përkthim të dorës së dytë, quhet i ndërmjetëm apo ndërmjetës.

Në faqen e brendshme shikojmë titullin origjinal të romanit. Emrin e përkthyeses Violanda Canko, të redaktore Donika Omari si dhe shtëpinë botuese që është «Elena Gjika». Gjithashtu marrim edhe informacionin se ky libër është botuar me ndihmën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë.

Ilustrimi që, siç thamë, sillet në kopertinën e romanit, është marrë nga çasti kur Matia Paskali me identitetin e tij të dytë si Adriano Meis ndodhet mbi urë, me kapelen pranë dhe me vështrimin e përhumbur në ujin e lumit që rrjedh përpara se të vendosë të kryejë vrasjen e tij të dytë.

Duhet të themi se ky përkthim nuk shoqërohet nga ndonjë parathënie.

Sa i përket Violanda Cankos, ajo është përkthyesë e njohur e gjuhës italiane. Ndër veprat e tjera të përkthyer prej saj kemi: Dacia Maraini: *Jeta e gjatë e Mariana Ukrias* (Shtëpia botuese «Elena Gjika», 2002); Grazia Deledda: *Kallamishte që i rreh era* (Shtëpia botuese «Elena Gjika», 2004); Alan Marshall: *Unë kapërcej pellgje* (shtëpia botuese «Naim Frashëri» 1998).

2. Studimi makrostrukturor

Niveli makrostrukturor përqendrohet kryesisht te shpërndarja e materialit tekstual në kapituj. Në ndryshim nga faza pararendëse paratekstuale, që trajton çështjet paraprake lidhur me botimin e teksteve të ndryshme të përkthyer, studimi makrostrukturor përfshin krahasimin e qartë të binomeve TGJO-TGJP. Kjo analizë përshkruar-krahasuese merr në konsideratë elementët paratekstualë të mëposhtëm: titulli i veprës, titujt e kapitujve në të cilët është ndarë materiali tekstual, prologu apo hyrja (nëse ka një të tillë) dhe shënimet që vetë autori i përfshin në veprën origjinale.

2.1 Titulli i veprës

Titulli i një vepre, sipas Nord-it (1994: 88 dhe vijim), përbën një lloj teksti që kryen një sërë funksionesh komunikuese, duke dalluar mes funksioneve themelore (që i jep çdo titull) dhe funksioneve shtesë. Të parat përfshijnë funksionin dallues (të identifikojnë tekstin duke e dalluar nga të tjerët), funksionin metatekstual (të informojnë lexuesin që ky teksti i përket një lloji tekstual të caktuar, me normat e tij gjuhësore, tipografike dhe stilistikore) dhe funksionin faktik (të vendosë një kontakt të parë me marrësit). Funksionet shtesë, nga ana e tyre, përfshijnë funksionin referencial apo përshkruar (të përshkruajnë tekstin apo disa nga aspektet e tij), funksionin shprehës (të komunikojnë lexuesit opinionin e emetuesit – emocione, gjykime vlerë – rreth tekstit dhe disa prej aspekteve të tij) dhe funksionin thirrës apo operativ, që i drejtohet drejtpërsëdrejti marrësit dhe që përfshin dy nënfunksiione: bindëse (të shtyjë marrësin të lexojë veprën) dhe drejtuese (ta udhëheqë gjatë leximit të tij drejt interpretimit të dëshiruar nga autori).

Titulli italisht i romanit, *Il fu Mattia Pascal*, përmbush – përveç funksioneve themelore – edhe atë referencial apo përshkruar. Që nga titulli e kuptojmë se bëhet fjalë për një histori personale të Matia Paskalit, personazh i trilluar, *përfaqësues i një aradhe të njerëzve të vegjël që popullojnë veprën pirandeliane, gjithnjë në kërkim të një realizimi të vetvetes dhe gjithnjë të detyruar të ulin kryet përballë marrëveshjeve të imponuara nga jetesa shoqërore*⁷⁴.

Për sa u përket zgjidhjeve përkthimore të titullit që ofrojnë dy librat e botuar në gjuhën shqipe, duhet thënë se titulli që CANKO i vendos veprës: *I ndjeri Matia Paskal*, përmbush të njëjtat funksione si titulli origjinal në gjuhën italiane. Ndërsa përkthimi i titullit nga RAMJA: *Tri herë vetvrasës* nxjerr në pah ndryshime domethënëse. Vëmë re se në këtë zgjedhje të përkthyesit hiqet informacioni që i referohet protagonistit të ngjarjes dhe vihet theksi te ngjarja, e cila do të rrëfëhet në roman. Funksioni shprehës që ky titull i zgjedhur nga RAMJA bart, nuk përputhet me atë që autori ka dashur të përcjellë me titullin e veprës origjinale.

2.2 Kapitujt dhe titujt e tyre

Përveç studimit të titullit të veprës origjinale dhe përkthimeve të ndryshme të tij, analiza makrostrukture përfshin edhe mënyrën e segmentimit të materialit tekstual dhe shpërndarjen e tij në kapituj. Lidhur me këtë *Il fu Mattia Pascal* përbëhet nga 18 kapituj. Dy të parët janë dy parathënie. Të gjithë kapitujt dallohen nga një numër romak dhe titulli. Nga botimi i Bemprad-it i vitit 1921, Pirandello i ka shtuar romanit një tjetër kapitull të titulluar «*Këshilla mbi skrupujt e fantazisë*». Citon në të dy fakte të çuditshme kronike të marra nga gazetata, nga të cilat i dyti është jashtëzakonisht i ngjashëm me atë të Matia Paskalit. Kjo është një përgjigje ndaj atyre që e kishin kritikuar për absurditet dhe pavërtetësi⁷⁵. Në të dyja përkthimet janë dhënë të gjithë kapitujt e romanit origjinal bashkë me shtojcën e fundit «*Këshilla mbi skrupujt e fantazisë*».

Lidhur me segmentimin e materialit tekstual në paragrafë, krahasimi mes binomeve TGJO-TGJP nxjerr në pah disa ndryshime në gjatësinë e paragrafëve, e motivuar nga organizimi i ri që ka bërë përkthyesi apo botuesi. Kështu vihet re se CANKO ka ruajtur organizimin e paragrafëve që ka bërë autori. Ndërsa te RAMJA kemi një organizim të ndryshëm. Për të dhënë vetëm një shembull.

... *E tiriamo innanzi. Chi ne parla più? Don Eligio Pellegrinotto mi fa però osservare che, per quanti sforzi facciamo nel crudele intento di strappare, di distruggere le illusioni che la provvida natura ci aveva create a fin di bene, non ci riusciamo. Per fortuna, l'uomo si distrae facilmente. Questo è vero. Il nostro Comune, in certe notti segnate nel calendario, non fa accendere i lampioni, e spesso – se è nuvolo – ci lascia al bujo. Il che vuol dire, in fondo, che noi anche oggi crediamo che la luna non stia per altro nel cielo, che per farci lume di notte, come il sole di giorno, e le stelle per offrirci un magnifico spettacolo. Sicuro. E dimentichiamo spesso e volentieri di essere atomi infinitesimali per rispettarci e ammirarci a vicenda, e siamo capaci di azzuffarci per un pezzettino di terra o di dolerci di certe cose, che, ove fossimo veramente compenetrati di quello che siamo,*

⁷⁴ Pirandello L., *Il fu Mattia Pascal*, Grandi Classici, la Spiga, f. 7.

⁷⁵ Italo Borzi (1993), parathënie e *Pirandello tuti i romanzi*, Newton&Compton Editori, Roma, fq. 184.

dovrebbero parerci miserie incalcolabili. Ebbene, in grazia di questa distrazione provvidenziale, oltre che per la stranezza del mio caso, io parlerò di me, ma quanto più brevemente mi sarà possibile, dando cioè soltanto quelle notizie che stimerò necessarie. Alcune di esse, certo, non mi faranno molto onore; ma io mi trovo ora in una condizione così eccezionale, che posso considerarmi come già fuori della vita; e dunque senza obblighi e senza scrupoli di sorta.

Cominciamo.

... Vazhdojmë. E kush i përmend më ato. Don Elixho më tha se me gjithë përpjekjet që bëjmë me qëllimin mizor që të shkëpusim, të shkatërrojmë iluzionet që natyra e urtë na kishte krijuar me qëllim të mirë, nuk ia dalim në krye. Fatmirësisht njeriu habitet lehtë. Kjo është e vërtetë. Komuna jonë në disa netë të shënuara në kalendar, nuk i ndez fenerët dhe kur ka re, na lë në errësirë. Kjo do të thotë se edhe sot mendojnë se hëna është në qiell vetëm që të na ndriçojë natën, ashtu si dielli gjatë ditës, ndërsa yjet të na japin një spektakël madhështor. Patjetër! Dhe harrojmë shpesh e me dëshirë, se jemi grimca pafundësisht të vogla për tu respektuar e admiruar me njëri-tjetrin, e jemi të zot të grindemi për një copë tokë e për vogëlsira të tjera të këtij lloji, që sikur të ishim me të vërtetë të vetëdijshëm se çfarë jemi, do të na dukeshin çikërrima. Pra për hir të këtij hutimi të dëshiruar dhe çudisë së rastit tim, do të flas për vehte sa më shkurt që të mundem, duke dhënë ato lajme që do t'i vlerësoj më të nevojshme. Sigurisht që disa nga ato nuk do të më nderojnë, por tani ndodhem në një gjendje nokdauni saqë mund të konsiderohem jashtë jetës. Pra, pa detyrime e skrupuj.

Fillojmë: (RAMJA, II, fq. 8)

Ky është vetëm një shembull i sjellë, por të tillë ka shumë në tekstin e përkthyer nga RAMJA. Kemi të bëjmë me një organizim të ri të materialit tekstual në paragrafë, madje edhe në fjali. Jo vetëm paragrafët, por vihet re se RAMJA ndryshon edhe strukturën e fjalive. Shkurton fjali që i konsideron të gjata dhe bashkon fjali të tjera.

Për sa i përket paraqitjes grafike të kapitujve në përkthimin e RAMJAS vëmë re se nuk sillen numri romak që shënon kapitullin dhe titujt e kapitujve nuk janë dhënë me germa të mëdha, por me germa të vogla. Ndërsa në përkthimin e CANKOS ruhet germa e madhe për titullin e kapitullit, por edhe këtu mungojnë numrat romakë të origjinalit.

Analiza makrostrukture përfshin gjithashtu studimin e përkthimit të titujve të kapitujve. Nga pikëpamja narrative, vepra, duke përfshirë parathëniet, mund të ndahet në tri blloqe themelore⁷⁶. Për analizën e zgjidhjeve të ndryshme përkthimore të zbatuara nga tekstet e përkthyer, është përdorur klasifikimi i mëposhtëm⁷⁷:

Përsëritje: përkthyesi riprodhon titullin apo një pjesë të tij ashtu siç del në tekstin burimor.

Përkthim fjalë për fjalë ose thujse fjalë për fjalë: ekziston një korrespondencë e strukturës dhe kuptimit mes TGJO dhe TGJP, dhe kjo korrespondencë përmbushet (thujse) fjalë për fjalë.

Përkthim i tërthortë: merret kuptimi i tekstit burimor, por nuk kemi një përputhje të strukturave. Kjo teknikë përbën një kategori të gjerë që përfshin nga ana e saj procedime të ndryshme: transpozicionin (ndryshim i kategorisë gramatikore), modulacionin (ndryshim i bazës konceptuale apo pikëpamjes), amplifikimin (përdorim i një numri të madh fjalësh në TGJP për të shprehur të njëjtën ide të –TGJO) dhe zhvendosjen (ndryshim i pozicionit të një elementi lidhur me vendin e tij në tekstin burimor).

Shtim: futje në tekstin burimor të elementëve të rinj leksikorë që sjellin informacion, i cili nuk është i pranishëm në tekstin origjinal.

Zëvendësim: titulli ose një pjesë e tij zëvendësohet me një tjetër segment tekstual që nuk e mbart kuptimin e TGJO-së.

Tkurrye: heqje e pjesëve të disa komponentëve leksikorë, duke sjellë si rezultat humbjen përkatëse të informacionit.

Heqje: zhdoket titulli në tërësinë e tij. Ky eliminim shoqërohet ndonjëherë me heqjen, të plotë apo të pjesëshme, të kapitullit.

Blloku i parë që përfshin kapitujt nga i treti deri tek i pesti, karakterizohet nga përshkrimi komiko-satirik i jetës së parë të Matia Paskalit. Brenda këtij grupi do të marrim në shqyrtim titujt e kapitujve të mëposhtëm:

LA CASA E LA TALPA (kap. III)
Shtëpia dhe urithi (RAMJA)
SHTËPIA DHE URITHI (CANKO)

FU COSI (kap. IV)
Kështu ishte (RAMJA)
KËSHTU NDODHI (CANKO)

MATURAZIONE (kap. V)
Pjekuria (RAMJA)
PJEKURIA (CANKO)

Në këta tre tituj të parë strategjia e ndjekur nga përkthyesit është e njëjtë: përkthim fjalë për fjalë e segmenteve tekstuale.

⁷⁶ L. Pirandello, *Il fu Mattia Pascal*, Meravigli Editrice, 1993, fq. 6.

⁷⁷ Të vihet re se në përkthimin e disa segmenteve tekstuale rezultojnë e vështirë të vendosen kufijtë mes një procedimi dhe tjetrit.

Blloku i dytë nga kapitulli i gjashtë deri tek i gjashtëmbëdhjeti përqendrohet tek arratia fantastike e protagonistit të romanit.

TAC TAC TAC... (kap. VI)
Tak, tak, tak... (RAMJA)
TAK TAK TAK... (CANKO)

Në përkthimin e titullit të kapitulli VI duhet të themi se atë që ka dashur të kumtojë autori nëpërmjet asinetit, e ka dhënë më mirë CANKO, ndërsa RAMJA ka preferuar të shtojë presjet duke e humbur emfazën e krijuar nga titulli origjinal.

CAMBIO TRENO (kap. VII)
Ndërroj tren (RAMJA)
NDËRROJ TREN (CANKO)

ADRIANO MEIS (kap. VIII)
Adriano Meis (RAMJA)
ADRIANO MEIS (CANKO)

UN PO' DI NEBBIA (kap. IX)
Pak mjegull (RAMJA)
NJË TIS MJEGULLE (CANKO)

ACQUASANTIERA E PORTACENERE (kap. X)
Mbajtësja e ujit të bekuar dhe taketukja (RAMJA)
MBAJTËSJA E UJIT TË BEKUAR DHE TAVLLA E DUHANIT (CANKO)

DI SERA, GUARDANDO IL FIUME (kap. XI)
Në mbrëmje, duke vështruar lumin (RAMJA)
MBRËMJEVE DUKE KUNDRUAR LUMIN (CANKO)

L'OCCHIO E PAPIANO (kap. XII)
Syri dhe Papiano (RAMJA)
SYRI DHE PAPIANOJA (CANKO)

Në përkthimin e këtyre kapitujve strategjia është e njëjtë. Përkthim fjalë për fjalë. Padyshim tek-tuk kemi ndonjë ndryshim në varësi të preferencës së përkthyesit ndaj kësaj apo asaj fjale në gjuhën shqipe.

IL LANTERNINO (kap. XIII)
Bishtuku (RAMJA)
FENERI I VOGËL (CANKO)

Në rastin e këtij titulli përkthyesja CANKO ka përdorur strategjinë e shtimit për të dhënë kuptimin e titullit origjinal, ndërsa RAMJA ka përdorur një fjalë, e cila nuk e përcjell kuptimin e titullit origjinal, «bishtuk» do të thotë kandil i thjeshtë për ndriçim.

LE PRODEZZE DI MAX (kap. XIV)
Bëmat e Maksit (RAMJA)
BËMAT E MAKSIT (CANKO)

IO E L'OMBRA MIA (kap. XV)
Unë dhe hija ime (RAMJA)
UNË DHE HIJA IME (CANKO)

IL RITRATTO DI MINERVA (kap. XVI)
Portreti i Minervës (RAMJA)
PORTRETI I MINERVËS (CANKO)

Strategjia e ndjekur nga përkthyesit për përkthimin e këtyre titujve të kapitujve është përkthimi fjalë për fjalë.

Blloku i tretë, që konsiston në dy kapitujt e fundit, paraqet kthimin në realitet.

RINCARNAZIONE (kap. XVII)
Rimishërimi (RAMJA)

RITRUPËZIMI (CANKO)

IL FU MATTIA PASCAL (kap. XVIII)
I ndjeri Matia Paskal (RAMJA)
I NDJERI MATIA PASKAL (CANKO)

AVVERTENZA SUGLI SCRUPOLI DELLA FANTASIA
Shënime mbi brerjet e ndërgjegjes së fantazisë (RAMJA)
KËSHILLA MBI SKRUPUJT E FANTAZISË (CANKO)

Në rastin e këtyre tre titujve të fundit mund të themi se strategjia është përsëri ajo mbizotëruese e përkthimit fjalë për fjalë. Të bie në sy se përkthimi i kapitullit, i cili mbart edhe titullin e të gjithë veprës, përkthehet nga RAMJA jo në të njëjtën mënyrë me titullin e veprës.

Në vend të përfundimeve

Qëllimi i këtij artikulli ishte të ofronte një model analize paratekstuale dhe mikrostrukture të një vepre letrare. Çështje paraprake që lidhen me publikimin e teksteve të ndryshme të përkthyer përbëjnë instrumentet që do të udhëheqin edhe analizën paratekstuale. Është e rëndësishme për studiuesin e përkthimit të dijë kronologjinë e botimeve të tekstit, përshkrimin fizik të librit të përkthyer, informacionin mbi botuesin, kolanën dhe përkthyesin etj.

Niveli makrostrukturor është ai që do i paraprijë analizës së përkthimit. Jemi tashmë në krahasimin mes tekstit origjinal dhe atij të përkthyer dhe studiuesi duhet të marrë fillimisht në konsideratë elementë të tillë si: titulli i veprës, titujt e kapitujve në të cilët është ndarë materiali tekstual, prologu apo hyrja (nëse ka një të tillë) dhe shënimet që vetë autori i përfshin në veprën origjinale.

Në analizën e përkthimeve të dy përkthyesve shqiptarë vumë re strategji të ndryshme në procesin përkthimor.

Literatura

1. BASSNETT Susan, 1993. *La traduzione: teorie e pratica*, Bompiani, Milano.
2. BLANCO Antonia Navarro, 1990, *La lengua y el estilo de Luigi Pirandello*, Sevilla (teze doktorate).
3. BORZI Italo, 1993, parathënie e *Pirandello tutti i romanzi*, Newton&Compton Editori, Roma.
4. CREPALDI Cinzia (nën kujdesin e), 2002, *Sintesi Il fu Mattia Pascal di Luigi Pirandello. Introduzione all'opera. Riassunto e analisi. Approfondimenti. Vita e opere dell'autore*, Avallardi, Milano.
5. ÇUÇKA Shpëtim, 1989, *Metodologia della traduzione*, shblu, Tiranë.
6. ECO Umberto, 2003, *Dire quasi la stessa cosa, Esperienze di traduzione*. Bompiani, Milano.
7. GENETTE Gérard, 1982, *Palimpsestes: la littérature au second degré*, Seuil, Paris.
8. GENTZLER Edwin, 1998, *Teorie della traduzione, Tendenze contemporanee*, UTET, Torino.
9. HURTADO ALBIR Amparo, 2001, *Traducción y traductología: Introducción a la Traductología*, Cátedra, Madrid.
10. KOKONA Vedat, 2003, *Mbi përkthimin, me përkthyesin*, Botimet Kokona, Tiranë.
11. NEWMARK Peter, 1981, *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford.
12. OSIMO Bruno, 2007, *La traduzione saggistica dall'inglese*, Hoepli, Milano.
13. PEÑA Salvador, 1997, *El traductor en su jaula: hacia una pauta de análisis de traducciones*, në Esther Morillas dhe Juan Pablo Arias (eds.) *El papel de traductor*, Salamanca: Ediciones Colegio de España, f. 19-57.
14. PAPA Mirela, 2011, *Mbi përkthimin në gjuhën shqipe të veprave të nobelistit Italian Luigi Pirandello* (temë doktorate)
15. PIRANDELLO Luigi, 2000. *Tri herë vetvrasës*, përkthyer nga Sabah Ramja, Helena Kadare, Shkodër.
16. PIRANDELLO Luigi, 2002. *I ndjeri Matia Paskal*, përkthyer nga Violanda Canko, Elena Gjika, Tiranë.
17. PIRANDELLO Luigi, 1993. *Il fu Mattia Pascal, Testo integrale, schede storiche e letterarie, note al testo*, Meravigli Editrice, Vimercate.
18. PIRANDELLO Luigi, *Il fu Mattia Pascal*, Grandi Classici, la Spiga.
19. PYM Anthony, 1998, *Method in Translation History*, St. Jerome, Manchester.
20. TUPJA Edmond, 2000, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë.